



Duke u bazuar në nenin 40 paragrafi 40.2 nen 1) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, nr.28 me dt. 04.06.2008, nenit 40 paragrafi 40.2 nen piken 11) të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe dispozitat e nenit 13 të Rregullores për Varrezat, Ofrimin e Shërbimit të Varrimit dhe Mirëmbajtjen e Tyre, nr.01-06-4911/17 të miratuar me datën 20.09.2017, me kërkesën e kryetarit të komunës me propozimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e vet të rregullt të III-të për vitin 2019 të mbajtur më dt. 29/03/2019, mori këtë;

V E N D I M

- I. **LEJOHËT**, kompensimi i shpenzimeve të varrimit në shumën prej 170.00 € (njëqind e shtatëdhjetë euro) për qytetaret e Komunës së Klinës.
- II. **PËRCAKTOHET**, se e drejta e parapare sipas pikës 1 të këtij vendimi, mund të realizohet me kërkesë nga familjari i të vdekurit, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e vdekjes.
- III. Dokumentacioni i nevojshëm për kompensimin e shpenzimeve, paraqitet nga familjari i të vdekurit, duke përfshirë:
 - 1.1. kërkesën;
 - 1.2. ekstrakti i lindjes së personit që ka ndërruar jetë;
 - 1.3. certifikata e vdekjes;
 - 1.4. dokumenti i identifikimit të familjarit së bashku me kopjen e xhirollogarisë bankare.
- IV. **OBLIGOHET**, Drejtoria e Administratës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që të administroj pranimin e kërkesave në baze të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi.
- V. **OBLIGOHET**, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit që pas përmbushjes së kushteve të parapara si në këtë vendim, t'i ekzekutoj mjetet për kompensimin e shpenzimeve të varrimit, si në pikën 1 të këtij vendimi.
- VI. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi paguhen nga kategoria buxhetore subvencione dhe transfere.
- VII. Ky vendim hynë në fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, përkatësisht 7 dite pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës, i cili do të fillojë të zbatohet nga data e hyrjes në fuqi.

Te njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra për informim, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

01Nr. 06-13274/2019
Klinë, më 02.04/2019

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

